

Disa herë kam sjellë në këtë Kuvend problemet që ekzistojnë sot në Shkodër: kriza ekonomike, varfëria, mungesa e investimeve, emigracioni e shumë e shumë plagë të tjera sociale. Asnjë nga këto çështje nuk u adresua në zërat e buxhetit të vitit të ardhshëm, por fatkeqësisht ky buxhet vendos vendin periferik që zë Shkodra në vullnetin dhe mendësinë e kësaj qeverie. Ndërkohë që Shkodra ndeshet me politika të tilla përjashtuese, financimet e qeverisë çojnë investime madhore direkt në vilat e oligarkëve të regjimit. Me të njëjtën gjendje përballet sot edhe zona e Dukagjinit. Sa shumë ka kontribuar në shtimin e vlerave të këtij vendi, por sa keq e sa në vështirësi është lënë kjo zonë dhe e tërë krahina. Gjatë takimeve të fundit me banorët e zonës, ata më kanë kërkuar që të ngre këtu disa çështje. E kam për nder t'i përfaqësoj dhe të bëhem zëri i fjalëve të tyre. Dukagjini, që mbijeton përballë vështirësive dhe harresës, është i përbërë nga tri njësi administrative: Pulti, Shoshi dhe Shala, si dhe prej gjithsej 23 fshatrash dhe tetë mijë banorësh. Rruga kryesore që përshkon këtë aks dhe këto tri njësi administrative është 68 kilometra nga Shkodra. Të themi të vërtetën, qëkurse i ka rënë dielli asaj toke, ajo rrugë nuk ka prekur asnjëherë ndonjë investim, duke u kthyer tashmë në një kalvar të mundimshëm për shkak të terrenit të ashpër, baltës dhe gurëve. Koha e udhëtimit shkon deri në gjashtë orë me mjete të larta. Një banor i zonës, për të marrë një shërbim mjekësor apo për të plotësuar disa nevoja të tjera jetësore në Shkodër, duhet të paguajë 15 deri në 20 mijë lekë të vjetra.

Ndërkohë, si mendoni ju, a u dalin pagat, ndërkohë që u duhet të përdorin transportin rreth 400 familje me ndihmë ekonomike, të cilave u duhet të përballen edhe me mungesën e bukës së përditshme, sigurimin e ilaçeve, shkollimin e fëmijëve? Ditët e fundit, dhe jo për herë të parë, është bërë shpallja e hartës nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për projektin e rrugës Unaza e Alpeve që, pas një publikimi politik, do të kalojë nga Prekali, Guri i Zi, Mali i Shoshit, Lotaj, Ndërlisaj dhe një degëzim nga Lotaj, Shala, Lekbibaj, Tropoja. Pavarësisht se është hera e dytë që ky projekt propozohet dhe banorët vazhdojnë me të njëjtën rrugë, projekti i ri, sipas shpalljes politike, anashkalon rrugën ekzistuese dhe sugjeron një rrugë të re me një terren shumë të thyer malor, që lë totalisht jashtë zonën e Pultit. Kjo konsiderohet nga banorët e asaj zone si një copëtim që po i bëhet Dukagjinit. Kërkesa e banorëve të malësisë së Dukagjinit është të dëgjohet zëri i tyre dhe rruga të përfshijë pa diskutim njësinë administrative të Pultit. Investimi sa më shpejt i këtij aksi rrugor do të sjellë zhvillimin ekonomik të zonës. Një tjetër shqetësim lidhet me dëmtimin e rëndë që po pëson një nga pasuritë e çmuara të tokës së Dukagjinit. Mbi 3 mijë hektarë pemë gështenje kanë qenë një burim i mirë për të ardhurat e banorëve, për eksportin, ku deri në vitin 2015 janë eksportuar sasi të konsiderueshme, por ka 5 vjet që masivi pyjor është dëmtuar nga një sëmundje dhe si pasojë e saj është tharë 50 % e kësaj pemëtarië. Ndaj kërkoj me këtë rast edhe ndërhyrjen e Ministrisë së Bujqësisë për të zgjidhur urgjent dhe në mënyrë konkrete këtë problematikë. Të nderuar deputetë, kombi i detyrohet malësisë së Dukagjinit, kombi u detyrohet pasardhësve të atyre grave dhe burrave qëndrestarë dhe qëndrestare, që ruajtën dhe mbrojtën trojet tona, ruajtën besimin, shpërndanë dijen dhe kulturën në shekuj.

Toka e Mëhill Markut, e Lin Delisë e Tinka Kurtit dhe e shumë personaliteteve të tjera, është edhe vendi i tre bijve martirë të kishës katolike, të lumët: Çiprian Nika, Gjeloş Lulashi dhe Qerim Sadiku. Ndaj, unë sot kërkoj nga ky Kuvend që kjo zonë të marrë vëmendjen e merituar. Faleminderit!